



BISHZ - VAIS - UIAS

BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELLECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

Mühledorfstrasse 13 - 3018 Bern • Email: sekretariati@bishz.ch • www.bishz.ch

RAPORTI VJETOR NR. 10

BISHZ - VAIS - UIAS

18.11.2006 - 23.11.2007

Dr. Sc. Ahmet XHIGOLI



RAPORTI VJETOR NR. 10

BISHZ - VAIS - UIAS

18.11.2006 - 23.11.2007

Dr. Sc. Ahmet XHIGOLI

Titulli:	RAPORTI VJETOR NR. 10
Faqe:	16
Viti:	2007
Vendi:	Bernë, Zvicër
Botuesi:	BISHZ, Mühledorfstrasse 13, 3018 Bern
Gjuha:	Shqip
Tirazhi:	70 kopje
U shpërndahet:	Anëtarëve të Kuvendit të dhjetë-jubilar të BISHZ-së dhe mysafirëve të ftuar.

Publikimin e këtij raporti e ka lejuar kryetari i Bashkimit të Intelektualëve Shqiptarë në Zvicër në Bernë më 21.11.2007, kurse shtypjen e tij e ka bërë arkëtari Ismet Rexhaj.

Copyright © BISHZ – VAIS – UIAS, Bern. Alle Rechte vorbehalten.

Lidhur me këtë raport

Ky raport paraqet aktivitetin e BISHZ-së në periudhën prej 19.11.2006 deri më 23.11.2007 dhe vlenë për Kuvendin e BISHZ-së. Dokumentet përcjellëse të tij janë: Statuti, Programi i punës, Rregullorja e Kryesisë, Paraqitja e Shoqatës, Vendimet e marrura nga mbledhjet e Kryesisë, Sekretariatit, Seksioneve, Grupeve punuese dhe Komisioneve të caktuara të BISHZ-së; Qëllimet e Shoqatës për vitin 2007; Protokolet e Kryesisë, Sekretariatit dhe Seksioneve. Raporti mund të zgjerohet me kërkesë të Kuvendit të BISHZ-së.

Raporti është i strukturuar në 7 kapituj. Në kapitullim e parë është dhënë një përshkrim i shkurtër i Kuvendit të nëntë të rregullt. Në kapitullin e dytë është dhënë definimi i aktiviteteve për vitin 2007.

Në kapitullin e tretë është dhënë veprimtaria e seksioneve. Shkurtimisht është përshkruar organizimi i promovimit dhe paraqitjes së pesë vëllimeve: E Djathta Shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike, organizimi i turnirit në futboll të vogël, organizimi i takimit familjar, dhe organizimi i tryezës së rrumbullakët tradicionale me rastin e 8-vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Në kapitujt 4 dhe 5 në formë tabelare është dhënë lista e aktivitetit të Kryesisë dhe Sekretariatit. Kapitulli i gjashtë jep të dhënat e aktivitetit të veprimtarisë botuese të BISHZ-së, kurse kapitulli i shtatë jep listën aktuale të udhëheqësisë së BISHZ-së.

Dr. Sc. Ahmet Xhigoli
Kryetar i BISHZ-së

Përmbajtja

Faqe

1.	Kuvendi i nëntë i rregullt	5
2.	Definimi i aktiviteteve për vitin 2007.....	6
3.	Veprimtaria e seksioneve të BISHZ-së	10
3.1.	Organizimi i promovimit të pesë vëllimeve: E Djathta Shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike	10
3.2.	Organizimi i Turnirit në futboll të vogël	12
3.3.	Organizimi i Takimit familjar.....	14
3.4.	Organizimi i Tryezës së Rrumbullakët me rastin e 8-vjetorit të çlirimit të Kosovës	15
3.	Kryesia	6
4.	Sekretariati	9
6.	Veprimtaria botuese	16
7.	Lista aktuale e udhëheqësisë së BISHZ-së	16

1. Kuvendi i nëntë rregullt

Më 18 nëntor 2006, në lokalet e hotelit Novotel Bern Expo në Bernë është mbajtur Kuvendi i nëntë i rregullt i BISHZ-së, promovimi i dy librave "Fisnikëria Helveto-Ilire" dhe "Amerika në sytë e mi" të autorit Agim Shehu dhe paraqitja e dy librave poetike "Pesha e gurit" dhe "Fillo me të mbarë" të autorit Mehmet Haxhosaj. Në Kuvend merrnin pjesë rreth 40 veta. Pjesëmarrës në Kuvend ishte edhe Ambasadori i Shqipërisë në Zvicër në Bernë, z. Mehmet Elezi dhe bashkëshortja e tij.

Në pjesën e parë të këtij takimi, nga ana e kryetarit është dhënë një vështrim i shkurtër i punës nëntëvjeçare të BISHZ-së, është paraqitur raporti i punës për periudhën 19.11.2005 - 17.11.2006. Në këtë takim, Kuvendi shpalli Anëtar Nderi shkrimtarin e mirënjohur z. Agim Shehu dhe ndau pesë mirënjohje dhe një falenderim.



Disa sequenca gjatë punimeve të Kuvendit dhe ndarjes së mirënjohjeve.

Në pjesën e dytë të këtij takimi është bërë promovimi dhe paraqitja e librave të përmendura, ku vetë autorët, në kohën prej një ore, folën lidhur me përmbajtjen e librave si dhe lexuan disa pjesë të tyre.



Disa sequenca me rastin e promovimit dhe paraqitjes së librave.

2. Definimi i aktiviteteve për vitin 2007

Në mbledhjen e kryesisë të datës 3 shkurt 2007 është aprovuar programi i aktiviteteve të ardhshme të BISHZ-së për këtë vit, si dhe plani i organizimit të mbledhjeve të kryesisë dhe sekretariatit. Në këtë drejtim janë definuar këto aktivitete themelore: aktualizimi i Web-faqës së BISHZ-së me të dhënat e reja dhe korigjimi i gabimeve ekzistuese; organizimi i promovimit të pesë vëllimeve: E Djalta Shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike; organizimi i një turniri në futboll të vogël; organizimi i një takimi familjar me anëtarët e i BISHZ-së dhe familjarët e tyre; organizimi i një tryeze të rrumbullakët me rastin e tetë-vjetorit të çlirimit të Kosovës; organizimi i Kuvendit të dhjetë-jubilar; shënimi i ditës së Flamurit; si dhe është theksuar që BISHZ-ja me vëmendje të përcjell zhvillimet në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, në trevat tjera shqiptare, Zvicër dhe që qëndrimet e saja lidhur me çfarëdo zhvillimi t'ia paraqesë opinionit shqiptarë, zvicëran dhe më gjërë.

3. Veprimtaria e seksioneve të BISHZ-së

Veprimtaria e seksioneve të BISHZ-së për këtë vit është bërë në formë të bashkuar. Në këtë drejtim janë realizuar: promovimi i pesë vëllimeve: E Djalta Shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike, një turnir në futboll të vogël, një takimi familjar, një tryezë e rrumbullakët me veprimtarët dhe intelektualët shqiptarë nga Zvicra; dhe më 24.11.2007 pas përmbylljeve të punimeve të Kuvendit të dhjetë-jubilar do të bëhet promovimi i një fjalori enciklopedik nga teknologjia e informacionit me indeks shqip, anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht të autorit Ali Mehmeti.

3.1. Organizimi i promovimit të pesë vëllimeve: E Djalta Shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike

Më 5 maj 2007, BISHZ-ja në bashkëpunim me Lidhjen e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë (LAPSH) të Gjenevës dhe me Këshillin Organizues për Ndrimimin e Historisë Shqiptare nga Gjermania ka organizuar promovimin e 5 vëllimeve të botuara nga Shtëpia Botuese Lumbardhi nga Prizreni me titull: E Djalta Shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike, me gjithësej 2006 faqe.

Promovimi i vëllimeve është bërë në dy pjesë sipas programit të planifikuar nga ana e BISHZ dhe LAPSH në Gjenevë.

Pjesa e parë e promovimit është organizuar në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Gjenevë në hapsirën-stendën e shtëpisë botuese "Botimpex" nga Tirana, prej orës 14.00 deri në ora 16.00.

Gjatë promovimit u zhvillua një diskutim i gjithanshëm për rolin dhe rëndësinë e këtyre botimeve si dhe pyetjeve të parashtruara ju përgjegjën anëtarët e Këshillit Organizues për ndrimimin e Historisë Shqiptare.



Tri sequenca të pjesëmarrësve brenda Panairit Ndërkombëtar të Librit para stendës "Botimpex" nga Tirana të pronarit dr. Eshref Bega.

Pjesa e dytë e promovimit të vëllimeve të përmendura është organizuar në lokalet e Universitetit Popullor Shqiptarë në Gjenevë prej orës 18.00 deri në ora 20.00.

Gjatë kësaj pjese, janë paraqitur vështrimet analitike të ligjëruesve. Në mungesë të z. Magjun Smajli, z. Avni Bilalli e ka paraqitur vështrimin rreth vëllimit të I-rë, z. Driton Kajtazi e ka paraqitur vështrimin rreth vëllimit të II-të, në mungesë të z. Ramadan Hoxhës, z. Abas Fejzullahi e ka paraqitur vështrimin rreth vëllimit të III-të, znj.

Valbona Krasniqi e ka paraqitur vështrimin rreth vëllimit të IV-të, kurse vështrimin rreth vëllimit të V-të e ka paraqitur z. Selman Etemi.

Gjatë referimit herë pas here z. Kristë Veseli me kavall dhe çifteli luajti melodi të këndëshme dhe përcjelli këngëtarin Sinan Gashin i cili këndoi këngë nga thesari i folklorit popullor shqiptarë që u priten me duartrokitje nga të pranishmit. Në vazhdim u zhvillua një diskutim i hapur nga të pranishmit dhe nga shumica u vlersua si një punë jashtzakonisht e madhe dhe frytdhënëse në këtë drejtim. Pyetjeve të parashtruara ju përgjigjen: Sekretari Organizativ i së Djathtës Shqiptare z. Nue Oroshi. Me diskutimet e tyre konstruktive u paraqiten edhe, Driton Kajtazi, Agim Paçarizi, Ahmet Xhigoli, Astrit Leka, etj.



Disa sequenca të pjesëmarrësve në pjesën e dytë të promovimit në lokalet e Universitetit Popullor Shqiptarë në Gjenevë.

Kryesia e BISHZ-së, i shpreh falenderime dhe përhëndetje të sinqerta Këshillit Organizues për Ndriqimin e Historisë Shqiptare nga Gjermania, LAPSH nga Gjeneva, referusëve të cilët morën pjesë me vështrimet e tyre në këtë promovim, dhe të gjithë anëtarëve të Shoqatës të cilët kontribuan në mbarëvajtjen shumë të mirë të promovimit të vëllimeve të përmendura.

3.2. Organizimi i Turnirit në futboll të vogël

Të dielën e 13 majit 2006, prej orës 12:00 deri në ora 16:00, Seksioni për sport i BISHZ-së ka organizuar Turnirin e katërt në futboll të vogël në Grenchen të Kantonit Solothurn.

Në këtë turnir morën pjesë 8 ekipe me rreth 60 lojtarë të moshave 10-14 vjeç, nga kantonet e ndryshme të Zvicrës, ku punojnë dhe jetojnë mërgimtarët tanë nga të gjitha trojet etnike. Pjesëmarrja e ekipeve sportive ishte Fr. 30 për ekip. Emrat e ekipeve që morën pjesë janë: Kosova-Lindore nga Bellach me trenerin e tyre Shaip Avdili, Dardania dhe Adana nga Grenchen me trenerin e tyre Agim Gerbavci, Prishtina nga Bellach me trenerin e tyre Adrian Xhigoli, Barcelona dhe Manchester nga Biberist me trenerin e tyre Rrahim Dakaj, Bern West nga Bernë me trenerin e tyre Ismet Rexhaj, dhe Struga nga Solothurn me trenerin e tyre Besmir Ramani. Çdo ekip përbëhej prej 7 lojtarëve.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve (lojtarëve, prindërve të lojtarëve, familjarëve të tyre, dashamirëve të sportit) në takimin e përmendur ishte rreth 120 veta.

Turniri filloi në ora 13:00. Pra, sipas palnit të përpiluar nga udhëheqësi i seksionit për sport i BISHZ-së, z. Agim Gerbavci.



Në anën e majtë dhe të djathtë shihen rreshtimit e lojtarëve dhe trenerëve, dhe gjithçka gati për të filluar lojërat e parapapara.



Në anën e majtë shihet një sequencë gjat gjuajtjes së në penalli, kurse në anën e djathtë disa lojtarë janë duke pritur ndeshjen e radhës.



Dy sequenca të lojtarëve të cilët janë në një pushim dhe të gatshëm për ndeshjet e radhës.

Ndeshjet filluan të zhvillohen paralelisht në dy fusha të cilat ishin shumë mirë të pajisura dhe të ndara sipas rregullave të futbollit të vogël. Në fushën e parë referuan z. Sinollah Shehu, nënkryetar i BISHZ-së dhe z. Besim Gërxhaliu, anëtar i Kryesisë të BISHZ-së, kurse në fushën e dytë referoi z. Agim Gerbavci, udhëheqës i seksionit për Sport i BISHZ-së. Gjithsej u zhvilluan 18 ndeshje.

Të gjitha ndeshjet e zhvilluara të këtij turniri ishin mjaft dinamike dhe u përcollën nga shikuesit me kureshtje. Vendin e parë në këtë turnir e mori ekipi Struga nga Solothurn (SO), vendin e dytë ekipi Prishtina nga Bellach (SO), kurse vendin e tretë ekipi Adana nga Grenchen (SO).

Pas përfundimit të të gjitha ndeshjeve, pasoi pjesa e ndarjes së medaleve, ku secilit lojtar të ekipit i është ndarë nga një medale e sponsoruar nga Kryesia dhe Seksioni për Sport i BISHZ-së.



Në anën e majtë janë lojtarët e ekipit "Struga" nga Solothurn (SO) me trenerin e tyre Besmir Ramani dhe sekretarin e BISHZ-së Abas Fejzullahi, në mes janë kryetari dhe nënkryetari i BISHZ-së, Ahmet Xhigoli dhe Sinollah Shehu, kurse në anën e djathtë janë lojtarët e ekipit "Prishtina" nga Bellach (SO), me trenerin e tyre Adrian Xhigoli.



Në anën e majtë janë lojtarët e ekipit "Manchester" nga Biberist (SO) me trenerin e tyre Rrahim Dakaj dhe trenerin e ekipit Barcelona, në mes janë lojtarët e ekipit "Struga" nga Solothurn (SO) me trenerin e tyre Besmir Ramani dhe disa familjarë të tyre, kurse në anën e djathtë janë lojtarët e ekipit "Adana" nga Grenchen (SO), me trenerin e tyre.



Në anën e majtë janë lojtarët e ekipit "Kosova Lindore" nga Bellach (SO) me trenerin e tyre Shaip Avdili, në mes janë lojtarët e ekipit "Bern West" nga Bernë (BE) me trenerin e tyre Ismet Rexhaj, kurse në anën e djathtë janë lojtarët e ekipeve "Manchester" dhe "Barcelona" nga Biberist (SO), me trenerët e tyre.

Në fund të kësaj paraqitje të shkurtër, për kontributin në përkrahjen dhe realizimin e këtij turniri, Kryesia e BISHZ-së posaçërisht i falënderon: udhëheqësin e Seksionit për Sport z. Agim Gerbavci, nënkryetarin BISHZ-së, inxh. i dipl. Sinollah Shehu; sekretarin e BISHZ-së, Abas Fejzullahi; arkëtarin e BISHZ-së, Ismet Rexhaj; këshillëtarët e BISHZ-së: Adnan Mehmeti dhe Besim Gërxfhaliu dhe të gjithë trenerët e ekipeve.

3.3. Organizimi i Takimit familjar

Më 19 maj 2006, prej orës 11.00-18.00, tek liqeni Champex-Lac afër Martinit në Kantonin Valis, Kryesia e BISHZ-së ka organizuar takimin familjar të anëtarëve të BISHZ-së dhe miqve të tyre, në formën shëtitje në natyrë.

Në këtë takim merrnin pjesë 10 familje nga vende të ndryshme të Zvicrës, nga Gjeneva, Berna, Solothurni, Bieli, etj., ku punojnë dhe jetojnë anëtarët e BISHZ-së dhe miqve të tyre, nga të gjitha trojet etnike. Pjesëmarrës në këtë takim ishin rreth 40 persona të brezeve të ndryshme.

Vendi ku u organizua takimi kishte pamje të mrekullueshme dhe bukuri të rrallë natyrore. Në këtë takim, të gjithë pjesëmarrësit paten drekën e përbashkët dhe kjo la një përshtypje jashtëzakonisht të mirë tek të gjithë. U bënë shëtitje në grupe rreth liqenit, biseda dhe fotografi familiare dhe të përbashkëta. Atmosfera dhe moti ishin të mrekullueshëm.

Takimi la përshtypje tek të gjithë dhe kishte propozime që në kësilloj ambienti të bëhen takime më të shpeshta.

Në fotografitë e dhëna poshtë shihen grupime të ndryshme të pjesëmarrësve të takimit, dhe me një disponim të veçantë.



Në fund të këtij përshkrimi të shkurtër, Kryesia e BISHZ-së u shpreh falënderime dhe pëershëndetje të singërta të gjithëve që morën pjesë në takimin familjar, të katërtin me radhë.

3.4. Organizimi i Tryezës së Rrumbullakët me rastin e 8-vjetorit të çlirimit të Kosovës

Më 9 qershor 2007, BISHZ-ja ka organizuar Tryezën e Rrumbullakët me veprimtarët dhe intelektualët shqiptarë nga Zvicra. Tryeza ishte e para e këtij lloji në këtë vit, dhe është organizuar me rastin e 8 vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Në këtë tryezë janë parqitur dy referate. Referatin e parë me titull "Fati i Pavarësisë së Kosovës dhe Faktori Ndërkombëtar" e paraqiti z. Abas Fejzullahi, kurse referatin e dytë me titull "Pavarësia e Kosovës dhe rruga e gjatë dhe e mundimshme drejt arritjes së saj" e paraqiti z. Imer Cacaj.

Tryeza është mbajtur në lokalet e Kishës Reformuese Bethlehem në Bernë, në të cilën morën pjesë 8 veta.



Në tryezën e përmendur u zhvillua një diskutim i gjithanshëm rreth punimeve të paraqitura, u parashtruan shumë pyetje nga të pranishmit dhe u dhanë përgjegjëjet nga referuesit.

Pas përfundimit të tryezës, pjesëmarrësit përpiluan një deklaratë, përmes së cilës BISHZ fton Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha, Kryetarin e Kosovës, z. Fatmir Sejdiu dhe Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, z. Agim Çeku që të Shpallin Pavarësinë së Kosovës.

Deklaratën e përmendur, BISHZ i'a ka dërguar po ashtu edhe katër gazetave ditore: Bota Sot, Zëri, Koha Ditore, Republika dhe tri web-faqeve: www.kosova.com, www.kosovapress.com, www.rtklive.com.

Le të përmendim, që deklaratën e BISHZ-së lidhur me thirrjen për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës e ka botuar vetëm gazeta Republika.

Kryesia e BISHZ-së, i shpreh falenderime dhe përhëndetje të sigjerta referuesëve të cilët morën pjesë me punime në këtë tryezë, gazetës Republika për botimin e deklaratës së përmendur, dhe të gjithë anëtarëve të Shoqatës të cilët kontribuan në mbarëvajtjen shumë të mirë të tryezës.

4. Kryesisa

Në këtë kapitull është dhënë lista e detalizuar e aktivitetit të Kryesisë në periudhën 18.11.2006 – 23.11.2007.

AKTIVITETI I GJERËTANISHËM I KRYESISË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	18.11.06	Kuvendi i nëntë i rregullt i BISHZ-së	<p>Vendi i mbajtjes: Hotel Novotel Bern Expo, Am Guisanplatz 2, 3014 Bern.</p> <p>Data: E shtunë, 18 nëntor 2006, 17.00 - 19.30</p> <p>Kryesues: Ahmet Xhigoli</p> <p>Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)</p> <p>Pjesëmarrës: 40</p> <p>Pikat e rendit të mbledhjes</p> <p>Pjesa e parë - Kuvendi i nëntë</p> <ul style="list-style-type: none"> Hapja e Kuvendit Fjala hyrëse dhe vështrim i shkurtë i punës nëntëvjeçare të BISHZ-së. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 19.11.2005 - 18.11.2006 Diskutim i hapur Ndarja e mirënjohjeve. Si më tutje? => E mirëpresim fjalën e të ftuarëve për Shoqatën BISHZ-së; këshilla, mendime, vërejtje, ide. Të ndryshme. Mbyllja e Kuvendit. <p>Pjesa e dytë: Promovim/Paraqitje të librave</p> <ul style="list-style-type: none"> Promovimi i librave "Fisnikëria Helveto-Ilire" dhe "Amerika në sytë e mi" të autorit Agim Shehu dhe paraqitja e dy librave poetike "Pesha e gurit" dhe "Fillo me të mbarë" të autorit Mehmet Haxhosaj. Fjala hyrëse dhe paraqitje e shkurtër e jetëshkrimit të Agim Shehut dhe Mehmet Haxhosaj Leximi i disa pjesëve të librave. <ul style="list-style-type: none"> Diskutim i hapur Mbyllja e promovimit <p>Pjesa e tretë: Darka e përbashkët me anëtarët e BISHZ-së, familjarët e tyre dhe mysafirët e ftuar.</p>	<p>Ftesë, Protokoli i Kuvendit të nëntë të rregullt</p> <p>Dokument</p> <p>Raporti nr. 9</p> <p>5 Mirënjohje</p> <p>Dokument</p>	<p>AXH, AF</p> <p>SSH</p> <p>AXH</p> <p>AXH</p> <p>Të gjithë AXH AF</p> <p>Të gjithë AXH</p> <p>AF</p> <p>A. Shehu M. Haxhosaj</p> <p>Të gjithë AF</p> <p>Të gjithë</p>
02	03.02.07	Mbledhja e parë e Kryesisë së BISHZ-së	<p>Vendi i mbajtjes: Restaurant Rüti, Rütliweg 98a, 3072 Ostermundigen-Bern</p> <p>E shtunë, 3 shkurt 2007 / 18.30-20.30</p> <p>Kryesues: Ahmet Xhigoli</p> <p>Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)</p> <p>Pjesëmarrës: 10 anëtarë</p> <p>Pikat e rendit të mbledhjes</p> <ul style="list-style-type: none"> Vërejtjet e protokolit të Kuvendit të nëntë të datës 18.11.06, dhe aprovimi i tij. Shqyrtimi i ndryshimit të Statutit dhe zgjedhjeve të reja për periudhën 2008-2011 <ul style="list-style-type: none"> Shqyrtimi i ndryshimit të Statutit (pjesa e zhdhëdhjes së Kryesisë). Plani kohor për zgjedhjet e reja të Kryesisë Zgjedhja e Kryetarit, Nënkyetarit, Sekretarit, Arkëtarit, Këshilltarëve/Administratorëve për mandatin 2008-2011. 	<p>Ftesë, Raporti vjetor nr. 9, Protokoli i mbledhjes së Kuvendit të nëntë</p>	<p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p>

AKTIVITETI I GJERËTANISHËM I KRYESISË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
			<ul style="list-style-type: none"> - Plani për paraqitjen e ndryshimeve të Statutit dhe nënshkruesëve të rinj në emër të BISHZ-së në zyrën e regjistrimit të firmave/shoqatave në Bernë • Organizimi i aktiviteteve për vitin 2007 <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i turnirit në futboll të vogël. - Organizimi i takimit familjar. - Organizimi i trezës së rumbullakët me rastin e tetë vjetorit të çlirimit të Kosovës. - Caktimi i aktiviteteve të tjera. - Organizimi i Kuvendit të dhjetë jubilar. - Plani i mbledhjeve të Kryesisë/Sekretariatit. • Qëllimet e BISHZ-së për periudhën 2008-2011. • Të ndryshme. 		<p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p>
03	24.03.07	Mbledhja e dytë e Kryesisë së BISHZ-së	<p>Vendi i mbajtjes: Restaurant Rüti, Rütiweg 98a, 3072 Ostermundigen-Bern</p> <p>E shtunë, 24 mars 2007 / 18.30-20.30</p> <p>Kryesues: Ahmet Xhigoli</p> <p>Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)</p> <p>Pjesëmarrës: 10 anëtarë</p> <p><u>Pikat e rendit të mbledhjes</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vërejtjet e protokolit të mbledhjes së Kryesisë të datës 03.02.07, dhe aprovimi i tij. • Propozimet për zgjedhjen e nënkryetarit, sekretarit dhe arkëtarit për periudhën 2008-2011. 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes së parë të Kryesisë	<p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>AF</p>
			<ul style="list-style-type: none"> • Kooptimi i anëtarëve të rinj në Kryesi • Organizimi i takimit në lojë topkëmbe për të vegjëlit të moshës 10-14 vjeç. • Organizimi i promovimit të pesë Vëllimeve (Grup- autorësh) të së Djathtës Shqiptare për Mbrojtjen e Shqipërisë Etnike. • Organizimi i takimit familjar • Organizimi i trezës së rumbullakët me rastin e tetëvjetorit të çlirimit të Kosovës. • Pagesa e anëtarësisë për vitin 2007. • Pagesa e llogarisë së firmës Switch lidhur me web-faqën e Shoqatës. • Organizimi i Kuvendit të dhjetëjubilar. • Plani definitiv i mbledhjeve të Kryesisë/Sekretariatit • Të ndryshme. 		<p>Të gjithë</p> <p>AG</p> <p>AF, IC</p> <p>XHS</p> <p>AXH</p> <p>IR</p> <p>AXH, IR</p> <p>Të gjithë</p> <p>AXH</p> <p>Të gjithë</p>
04	28.04.07	Mbledhja e tretë e Kryesisë së BISHZ-së	<p>Vendi i mbajtjes: Restaurant Rüti, Rütiweg 98a, 3072 Ostermundigen-Bern</p> <p>E shtunë, 28 prill 2007 / 18.30-20.30</p> <p>Kryesues: Ahmet Xhigoli</p> <p>Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)</p> <p>Pjesëmarrës: 10 anëtarë</p> <p><u>Pikat e rendit të mbledhjes</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vërejtjet e protokolit të mbledhjes së Kryesisë të datës 24.03.07, dhe aprovimi i tij. • Organizimi i promovimit të pesë Vëllimeve (Grup- autorësh) të së Djathtës Shqiptare për Mbrojtjen e Shqipërisë Etnike më 05.05.2007 • Organizimi i takimit në lojë topkëmbe për të vegjëlit të moshës 10-14 vjeç më 13.05.2007 • Organizimi i takimit familjar më 19.05.2007. 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes së dytë të Kryesisë	<p>AXH</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p>

AKTIVITETI I GJERËTANISHËM I KRYESISË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
			<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i tryezës së rrumbullakët me rastin e tetëvjetorit të çlirimit të Kosovës më 09.06.2007 Pagesa e anëtarësisë për vitin 2007. Të ndryshme. 		Të gjithë IR Të gjithë
05	22.09.07	Mbledhja e katërt e Kryesisë së BISHZ-së	<p>Vendi i mbajtjes: Restaurant Rüti, Rütiweg 98a, 3072 Ostermundigen-Bern E shtunë, 22 shtator 2007 / 18.30-20.30 Kryesues: Ahmet Xhigoli Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar) Pjesëmarrës: 10 anëtarë</p> <p><u>Pikat e rendit të mbledhjes</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Vërejtjet e protokolit të mbledhjes së Kryesisë të datës 28.04.07, dhe aprovimi i tij. Organizimi i dy tryezave (njëra në Bernë dhe tjetra në Gjenevë) të rrumbullakëta me Prorektorin e Universitetit të Prishtinës z. Luan Ahma dhe me zëvendës Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës, z. Fevzi Berisha. <ul style="list-style-type: none"> Rezervimi i lokaleve në Bernë deri më 25.09.2007 Rezervimi i lokaleve në Gjenevë deri më 25.09.2007 Lista e të ftuarëve, dërgimi i ftesave dhe njoftimi në mjetet e infomimit dhe në faqën e Shoqatës deri më 25.09.2007. Aktivitetet tjera deri në fund të vitit 2007. <ul style="list-style-type: none"> Parapërgatitjet për Kuvendin e dhjetë - jubilar (zgjedhjet, detyrat, etj.) Festimi i ditës së Flamurit Të ndryshme. 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes së tretë të Kryesisë	AXH Të gjithë AXH, AF AXH, IR IC, VK AXH Të gjithë Të gjithë Të gjithë Të gjithë
06	09.06.07	Deklaratë	<p>Deklaratë e BISHZ-së, përmes së cilës BISHZ fton Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha, Kryetarin e Kosovës, z. Fatmir Sejdiu dhe Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, z. Agim Çeku që të Shpallin Pavarësisë së Kosovës. Deklarata u është dërguar katër gazetave ditore: Bota Sot, Zëri, Koha Ditore, Republika dhe tri web-faqeve: www.kosova.com, www.kosovapress.com, www.rtklive.com.</p>	Deklaratë	AXH

Vërejtje: Në periudhën 18.11.2006–23.11.2007, të gjithë anëtarët aktual të kryesisë së BISHZ-së kanë treguar angazhim të duhur siq është pritur.

5. Sekretariati

Në këtë kapitull janë dhënë disa prej aktiviteteve të Sekretariatit në vitin 2007.

AKTIVITETI I GJERËTANISHËM I SEKRETARIATIT					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	03.02.07	Mbledhja e parë e Sekretariatit të BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: Restaurant Rüti, Rütiweg 98a, 3072 Ostermundigen-Bern Data: E shtunë, 3 shkurt 2007 / 17.30-18.30 Kryesues: Ahmet Xhigoli Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar) Pjesëmarrës: Ahmet Xhigoli, Sinollah Shehu, Abas Fejzullahi, Ismet Rexhaj. <u>Pikat e rendit të mbledhjes</u> <ul style="list-style-type: none"> Shqyrtimi i rrjedhës së pikave të rendit të mbledhjes parë të kryesisë Plani i aktiviteteve të BISHZ-së për vitin 2007. Plani i organizimit të mbledhjeve të Kryesisë, Sekretariatit dhe Kuvendit të dhjetë-jubilar. Të ndryshme 	Ftesë, Raporti vjetor nr. 9, Protokoli i mbledhjes së Kuvendit të nëntë	AXH Të gjithë AXH AXH Të gjithë
02	24.03.07	Mbledhja e dytë e Sekretariatit të BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: Restaurant Rüti, Rütiweg 98a, 3072 Ostermundigen-Bern Data: E shtunë, 24 mars 2007 / 17.30-18.30 Kryesues dhe protokoli: Ahmet Xhigoli Pjesëmarrës: Ahmet Xhigoli, Ismet Rexhaj <u>Pika e rendit të mbledhjes</u> <ul style="list-style-type: none"> Gjendja e pagesës së anëtarësisë për vitin 2007. 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes së parë të Sekretariatit	AXH AXH, IR
03	28.04.07	Mbledhja e tretë e Sekretariatit të BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: Restaurant Rüti, Rütiweg 98a, 3072 Ostermundigen-Bern Data: E shtunë, 28 prill 2007 / 17.30-18.30 Kryesues: Ahmet Xhigoli Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar) Pjesëmarrës: Ahmet Xhigoli, Sinollah Shehu, Abas Fejzullahi, Ismet Rexhaj. <u>Pikat e rendit të mbledhjes</u> <ul style="list-style-type: none"> Gjendja e pagesës së anëtarësisë për vitin 2007. Buxheti për aktivitetet e planifikuara për këtë vit 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes së dytë të Sekretariatit	AXH AXH, IR Të gjithë
04	21.11.07	Mbledhja e katërt e Sekretariatit të BISHZ-së	Vendi i mbajtjes: Restaurant Rüti, Rütiweg 98a, 3072 Ostermundigen-Bern Data: E shtunë, 21 nëntor 2007 / 17.30-18.30 Kryesues dhe protokoli: Ahmet Xhigoli Pjesëmarrës: Ahmet Xhigoli, Ismet Rexhaj <u>Pikat e rendit të mbledhjes</u> <ul style="list-style-type: none"> Shtypja e raportit vjetor nr. 10 Shtypja e mirënjohjeve 	Ftesë, Protokoli i mbledhjes së tretë të Sekretariatit	AXH IR, AXH AXH

Vërejtje: Në vitin 2007, anëtarët e sekretariatit të BISHZ-së kanë treguar angazhim të duhur siq është pritur.

6. Veprimtaria botuese

Në këtë kapitull është dhënë lista e botimeve të brendëshme të BISHZ-së për këtë vit.

BOTIMET E BRENDESHME TË BISHZ-SË		
Nr.	Titulli i botimit	Përshkrimi
01	<i>Qëllimet e BISHZ-së për vitin 2007. BISHZ-Bernë, 2007.</i>	Dokumenti përshkruan qëllimet e BISHZ-së për vitin 2007.
02	<i>Bilanci i BISHZ-së për vitin 2007. BISHZ-Bernë, 2007.</i>	Dokumenti paraqet të dhënat e bilancit dhe saldon për vitin 2007 të BISHZ-së
03	<i>Raporti nr. 10 i BISHZ-së. BISHZ-Bernë, 2007.</i>	Dokumenti përshkruan aktivitetin e BISHZ-së për vitin 2007.

7. Lista aktuale e udhëheqësisë së BISHZ-së

Në këtë kapitull është dhënë lista aktuale e udhëheqësisë së BISHZ-së dhe roli i tyre.

Nr.	Shkurtesa	Emri e mbiemri	Roli në BISHZ	Roli tjetër në BISHZ
1.	AXH	Ahmet Xhigoli	Kryetar	Udhëheqës i seksionit për veprimtari botuese; Udhëheqës i seksionit për informim.
2.	SSH	Sinollah Shehu	Nënkryetar	Udhëheqës i seksionit për teknikë.
3.	AF	Abas Fejzullahi	Sekretar	Anëtar i komisionit statutar.
4.	IR	Ismet Rexhaj	Arkëtar	Udhëheqës i seksionit për ekonomi; Fotograf dhe kameraman.
5.	XHS	Xhevat Salihu	Këshilltar	Udhëheqës i seksionit për shëndetësi.
6.	VK	Valbona Krasniqi	Këshilltare	Udhëheqëse e seksionit për kulturë.
7.	AM	Adnan Mehmeti	Këshilltar	Zënvendësudhëheqës i seksionit për veprimtari botuese; Kryetar i komisionit të kontroll-revizionit.
8.	FR	Florije Rexhaj	Këshilltare	Udhëheqëse e seksionit për çështje sociale-integrim.
9.	AG	Aqim Gerbavci	Këshilltar	Udhëheqës i seksionit për sport.
10.	VG	Venera Gërxhaliu	Këshilltare	Zënvendësudhëheqëse i seksionit për përkthime.
11.	GB	Gani Balaj	Këshilltar	Udhëheqës i seksionit për diplomaci-politikë.
12.	FTH	Florin Thaçi	Këshilltar	Zënvendësudhëheqës i seksionit për shëndetësi; Anëtar i komisionit statutar.
13.	RB	Resmije Berisha	Këshilltare	Udhëheqëse e seksionit për arsim.
14.	BG	Besim Gërxhaliu	Këshilltar	Udhëheqës e seksionit për përkthime.
15.	SHR	Shkumbin Rmoku	Administrator	Bashkëpunëtor në seksionin për veprimtari botuese.
16.	SJ	Skender Jusufi		Kryetar i komisionit statutar.
17.	RSH	Ramiz Shabani		Anëtar i komisionit të kontroll-revizionit.